

PRAKTIKA TË MIRA PËR TË NXËNËT NË KLASË NGA MËSUESIT E EKIPIT LËNDOR TË SHKENCAVE SOCIALE, GJUHËS DHE KOMUNIKIMIT

1.METODA “PUNË NË GRUPE”

Në orën mësimore të lëndës Filozofi, klasa 11, me temë: *Projekti* “Ah moj demokraci” u trajtuan konceptet kryesore: demokraci, politikë, drejtësi, parime, virtyte, idealizëm, urtësia, harmoni, bashkësi, dialog, pyetje sokratike, pushtet, ligj, mirësi, edukim, dije, ide, analizë, njohje, e vërtetë, shpirt, remineshencë, shteti ideal, mbreti filozof, rini, moral, kafshë politike.

Metodat e përdorura ishin: intervista, dialogje, punë në grup, punë e drejtuar, bashkëbisedim, lojëra filozofike, krijime, zgjidhje problemesh, vetëreflektim, lexim me zë të lartë, pyetje-përgjigje, lojë me role, të parashikuara në planin e orës mësimore më mundësuan që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë.

Metodat u zbatuan në këtë mënyrë:

- Klasa u nda në tre grupe.
- Çdo grup punoi për një nga filozofët e antikitetit grek: Sokrati, Platoni, Aristoteli.
- Grupi zgjodhi drejtuesin që koordinonte punët studimore dhe prezantuese. Brenda grupit pati ndarje detyrash: hulumtim materialesh (nga interneti dhe libra filozofikë, nga media e shkruar dhe audiovizive), punim videosh prezantuese, përgatitje lojërash filozofike, dialogjesh, rolesh, shkrime analitike e kritike.
- Gjatë prezantimit të fazës së parë të projektit pati një hyrje me vargje të Pano Taços nga poezia “Ah moj Demokraci” dhe në mbyllje një pjesëz, një mesazh të fortë nga monodrama “Apologjia e Sokratit” nga Mirush Kabashi, për të pasur ndërthurje me zhvillimin e aftësive kërkuese e prezantuese artistiko-letrare. Kjo ndërthurje e bëri këtë orë filozofie edhe më interesante dhe emocionuese, sepse nxënësit kuptuan dhe zhvilluan brenda vetes se edhe vetë filozofia është një art: arti i të menduarit, ai i cili na shoqëron kudo.

Projekti pati qëllim parësor nxitjen e mendimit kritik, refleksionin, introspeksionin, zhvillimin e aftësisë së të folurit në publik, shkrimin analitik, shprehjen e mendimit, nxitjen e diskutimit të pikëpamjeve të ndryshme, gjetjen e zgjidhjeve për problemet aktuale, por edhe argëtimin më lojëra, intervista etj.

Çdo grup pati mënyra prezantimi të veçanta.

- Grupi i Sokratit: Video me informacione, shkrime analitike (gjendja e demokracisë shqiptare), dialog sokratik, pyetje sokratike dhe shpërndarje kartolinash;
- Grupi i Platonit: video, lojëra filozofike, shkrime analitike, mbajtje fjalimi (Ç’do t’u thoshte Platoni qytetarëve të Shqipërisë sot?), lojëra filozofike, shpërndarje thëniesh;
- Grupi i Aristotelit: poërpunt me filozofinë e Aristotelit, informacione shtesë mbi rëndësinë e Kushtetutës, bashkësisë etj., fjalim në rolin e Aristotelit, pyetje-përgjigje, intervista me audiencën.

Çdo informacion teorik i përpunuar dhe i prezantuar në video e powerpoint është konkretizuar në shkrimet analitike mbi realitetin shqiptar, gjendjen e demokracisë në Shqipëri dhe problematikat e saj.

- Të gjitha grupet punuan postera, foto, thënie filozofësh, skica, ndanë ide dhe punuan për të krijuar një skenografi të përshtatshme për të krijuar në klasë atmosferën e një ore të rikthyer në antikitet dhe rikthyer në ditët e sotme.
- Gjithashu u punua këndi i filozofisë, si pjesë e këtij projekti.
- Më pas, gjatë prezantimit të punës së secilit grup me nga 15 minuta (ku pati dhe ndërthurje mes tyre, sidomos në hyrje dhe në mbyllje), u vu re që prezantimet e tyre ishin mjaft interesante. Ata jo vetëm ngritën probleme dhe e panë me syrin kritik realitetin, por gjithashtu ndërvepruan me njëri-tjetrin, me mësuesit e ftuar, ndanë mendime, krijuan atmosferë të këndshme me lojëra filozofike dhe intervista të shkurtra, duke i vënë të gjithë të mendonin, sic i takon një momenti filozofik. Nxënësit dhanë mesazhet/zgjidhjet e tyre se si ta çojnë përpara demokracinë dhe të ardhmen e Shqipërisë.

Të gjithë nxënësit u përfshinë në këtë orë projekti duke shfaqur aftësitë dhe talentet e tyre (video, krijime, kërkime, shkrime analizash, lexime, recitim, intervistim, punime artistike, teknologjike), por gjithashtu arritja ishte që u nxitën të flasin në publik nxënës që të folurën në publik e kanë pasur të vështirë, u nxitën të lexojnë apo mësojnë gjëra të reja nxënës të një niveli më të dobët. U mësuan informacione të reja përtej tekstit mësimor, u bënë kërkime më të thelluara nga të tjerë, u perfeksionuan vlera si korrektesa, përgjegjshmëria, bashkëpunimi në grup, rritja e kohezionit, u përjetuan emocionet e bukura të një prezantimi projekti filozofik.

E rëndësishme është që nxënësit të arrijnë të reflektojnë mbi ato që mësojnë, t'i vënë në përdorim në jetën e përditshme ato që mësojnë në teori dhe të kalojnë në nivelin elitare të nxënies: pra të jenë ata që japin filozofinë e tyre për jetën tonë. Në këtë fazë të parë të projektit, kjo u arrit. Ky është procesi i rritjes së tyre si njerëz, si qytetarë, i cili vjen gradualisht nga çdo organizim/projekt/aktivitet/konkurs/krijimqë punojmë bashkë.

Mësuesja: Orilda Kalami

orilda.kalami@gea.edu.al

2.METODA “PUNË ME FISHA”

Në orën mësimore të lëndës “Gjuhë shqipe”, klasa e 7A, me temë mësimore “Mbiemri” dhe me koncept kryesor *përshtatja e mbiemrit me emrin*, metoda ‘punë me fisha’, e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Metoda u zbatua në këtë mënyrë:

- Klasa u organizua në 5 grupe me nga 4 veta dhe për secilin grup u ndanë fisha, në të cilat ishin shënuar nga dy grupe emërore. Nxënësit do të shikonin nëse ishte bërë saktë përshtatja e mbiemrit me emrin në këto grupe emërore. Kujdes i veçantë duhej treguar te emrat e dygjinishëm.
- Nxënësit punuan në mënyrë të pavarur, duke diskutuar me njëri-tjetrin për detyrën rreth 5 minuta.

- Më pas, nga secili grup u përgjigjën dy-tre nxënës, duke treguar variantin e saktë të përgjigjes, shoqëruar me shpjegimin përkatës.

Me anë të kësaj pune u bë e mundur lidhja e temës së kaluar “Emrat e dygjinishëm” me temën e re mësimore “Mbiemri”, dhe u theksua koncepti kryesor i temës së re mësimore: *Përshatja e mbiemrit me emrin*. Gjatë prezantimit të punës së secilit grup me nga 4 minuta, u vu re që nxënësit e kishin përvetësuar shumë mirë konceptin e përshatjes së mbiemrit me emrin dhe arsyetuan saktë për zgjidhjen e ushtrimit.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën e punës me fisha, sepse ajo krijon një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënë.

Mësuesja: Blerta Laçi

blerta.laci@gea.edu.al

3.METODA “KONKURS ME GRUPE”

Në orën mësimore të lëndës gjuhë shqipe, klasa VI-A me temë mësimore “Ushtrime për përemrat” dhe me koncept kryesor përemri vector dhe trajtat e shkurtra, metoda e konkursit me grupe, e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Metoda/teknika u zbatua në këtë mënyrë.

E organizova klasën në tri grupe me nga tetë anëtarë. Secilit prej grupeve i caktova një detyrë.

- Grupi i parë pati për detyrë të zgjidhte formën e duhur të përemrit vector dhe të trajtës së shkurtër duke argumentuar zgjedhjen.
- Grupi i dytë pati për detyrë të gjente përemrat vectorë në fjalitë e dhëna dhe të përcaktonte vetën, numrin dhe rasën.
- Grupi i tretë pati për detyrë të gjente trajtat e shkurtra të përdorura në fjali dhe t'i shkruante si duhet duke përcaktuar rasën dhe vetën e tyre,

Secili grup punoi për detyrën, duke bashkërenduar punën e të gjithë anëtarëve brenda grupit. Nxënësit punuan për dhjetë minuta të ndarë në grupe. U monitorua nga mësuesja puna e secilit grup, por dhe janë udhëzuar dhe lehtësuar punët e secilit grup. Më pas, gjatë prezantimit të punës së secilit grup, u aktivizuan të gjithë nxënësit dhe me përgjigjet e tyre u përmbush arritja e rezultatit të të nxënit që ishte vendosur për konceptin e trajtuar. Fitoi grupi që bëri më pak gabime.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën e konkursit me grupe sepse ajo krijon një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënë.

Mësuesja: Albana Shabani

albana.shabani@gea.edu.al

4.METODA E KËRKIM-ZBULIMIT (GRUPE DYSHE), PYETJE-PËRGJIGJE

Në orën mësimore të lëndës “Gjeografi”, klasa e 7A, me temë mësimore “Zonat klimatike” dhe me koncept kryesor *tipet e zonës së nxehtë*, metodat e parashikuara në planin e orës mësimore më mundësuan që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Metodat u zbatua në këtë mënyrë:

- Për të realizuar metodën e kërkimzbulimit, klasa u organizua në grupe dyshe dhe secili grup do të shkruante në një fletë faktorët e formimit të klimës.
- Nxënësit do të rendisnin faktorët e formimit të klimës, dhe do t'u jepnin përgjigje pyetjeve: Cilat janë zonat klimatike? Çfarë tipi klime ka çdo zonë? Etj.
- Pyetjet orientojnë drejt vëmendjen e nxënësve për të hulumtuar për përgjigjet që lidhen me konceptet kyçe të temës mësimore. Pyetjet gjithashtu nxitin të mënduarin dhe duke i ndërtuar sipas niveleve ato sigurojnë gjithëpërfshirje të nxënësve. Mua më pëlqen që të kërkoj shpjegime, argumentime, thellime në të menduar ndaj pyetja Pse? Shoqëron shumë përgjigje të dhëna më parë nga nxënësi. Gjykoj të rëndësishme që mësuesi të nxitë nëpërmjet pyetjeve dhe për mua kjo është e efekshme. Më pas, nxënësit do të dallojnë në hartë zonat sipas klimave.
- Gjatë prezantimit të punës së secilit grup, u vu re që nxënësit e kishin përvetësuar shumë mirë konceptin *tipet e zonës së nxehtë* dhe gjithashtu u orientuan shumë mirë në hartë për gjetjen e zonave klimatike..

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën e kërkim-zbulimit në grupe dyshe si dhe teknikën pyetje-përgjigje, sepse ajo krijon një ndërveprim mes nxënësve dhe përfshirje të lartë në të nxënë.

Mësuesja: Jeta Melengu

jeta.melengu@gea.edu.al

5.METODAT “PUNË NË GRUPE” DHE “LOJA E ALFABETIT”

Në orën mësimore të lëndës histori, klasa Xb me temë mësimore *Absolutizmi francez* dhe me koncept kryesor absolutizëm, pushtet, demokracia, sundim etj, metodat e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësuan që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Metodat u zbatuan në këtë mënyrë.

- Në fazën e përforcimit të njohurive, u përdor metoda e punës në grupe nëpërmjet lojës, ku klasa u nda në 4 grupe me 4 nxënës dhe secili prej grupeve punoi për të gjetur e shkruar sipas rendit alfabetik të gjitha konceptet që u morën gjatë orës mësimore.
- Klasës i jepet një kohë rreth 4 min për të shkruar gjithë konceptet që ju kujtohen, pas kësaj secili prej grupeve lexon fjalët që kanë shkruar. (Grupet nxiten të zgjedhin të emërtohen me emra gazmorë, sepse kjo krijon klimë pozitive, të çlirët, rrit vetëbesimin dhe tregon karakterin e grupit dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe më pas përgjigjet lexohen me zë.)
- Krijohet një mjedis sa informues aq edhe argëtues mes nxënësve. Nxënësit përfshihen të gjithë në punën me grupe dhe aktivizohen sepse në vetvete ky proces funksionon si lojë.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën e punës në grupe dhe lojën e alfabetit, sepse ajo krijon një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënë.

Mësuesja: Elena Mihal

e.mihal@gea.edu.al

6.METODA “KARRIKIA E AUTORIT”

Në orën mësimore të lëndës Letërsi, klasa e 10-B, me temë mësimore “Jeta dhe krijimtaria e Euripidit” dhe me koncepte kryesore ‘Tipat e heronjve’, ‘Konflikti tragjik’ dhe Koncepti moral i së drejtës’ teknika ‘Karrikia e autorit’, e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që pjesa më e madhe e nxënësve të përfshiheshin në të nxënë. Metoda u zbatua në këtë mënyrë:

- Për të përforcuar njohuritë e marra një orë më parë dhe për t’i përfshirë të gjithë nxënësit, përzgjodha një nxënëse për ta ulur në karrigen e autorit.
- Pyetjet rreth temës nuk i bëra unë, por vetë nxënësit. Secili prej tyre i drejtoi një pyetje autorit lidhur me momentet kryesore të jetës së tij dhe risitë që solli në teatrin antik grek. Vura re që pyetjet e drejtuara prej tyre ishin të nivelit të ulët, mesatar dhe të lartë dhe përmes pyetjeve të drejtuara doli në pah përgatitja e nxënësve për temën mësimore.
- Nxënësja e ulur në karrigen e autorit dha përgjigje të sakta, të plota, të mirargumentuara përpara shokëve dhe shoqeve të saj.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin herë pas here metodën e karriges së autorit sepse i përfshin të gjithë ose pothuaj të gjithë nxënësit në të nxënë dhe po ashtu i ndihmon ata të mësojnë se si të ndërtojnë pyetje rreth temës, të evidentojnë konceptet kryesore të një teme të caktuar, të thellohen në të kuptuar.

Mësuesja: Enkelejda Çaça

enkelejda.caca@gea.edu.al